



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1660/ 7 prot.

Datë 16.06.2026

V E N D I M

Nr. 811/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtare

Në mbledhjen e datës 16.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALBAVIA Sh.p.k” në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-76125-02-13-2026, me objekt “Rikualifikimi i bllokut të banimit në rrugët Nexhat Agolli, Nikolla Dushniku, Ndoc Nikaj”, me fond limit 141,720,264.94 (njëqind e dyzet e një milion e shtatëqind e njëzet mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Ankimues:

OE “ALBAVIA” Shpk me NUIS J81527001Q, me adresë: Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia e Tiranës, me adresë: Lagjja, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit*

Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.02.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-76125-02-13-2026, me objekt “*Rikualifikimi i bllokut të banimit në rrugët Nexhat Agolli, Nikolla Dushniku, Ndoc Nikaj*”, me fond limit 141,720,264.94 (njëqind e dyzet e një milion e shtatëqind e njëzet mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

II.2. Në datën 06.03.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 12.05.2026, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “SHPRESA - AL” shpk: 79,328,227.60 I Skualifikuar
2. Operatori Ekonomik “ALBAVIA” shpk 80,884,283.16 I Skualifikuar
3. Operatori Ekonomik “INERTI” shpk Vlera: 81,194,080.64 I Kualifikuar
4. Operatori Ekonomik “NDERTIMI shpk” 83,541,185.00 I Kualifikuar
5. AGI KONS” shpk & “C O L O M B O” shpk 84,194,811.00 I Kualifikuar
6. Operatori Ekonomik “MELA.” Shpk 86,156,680.38 I Skualifikuar
7. Operatori ekonomik “NIKA” shpk 86,443,883.21 I Skualifikuar
8. “2 N” shpk & “SELAMI” shpk 87,000,000.00 I Kualifikuar
9. “MF INVEST GROUP” shpk & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk 87,496,894.20 I Skualifikuar
10. Operatori Ekonomik “K A C D E D J A” shpk 87,808,394.04 I Skualifikuar
11. Operatori Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” shpk 88,595,901.14 I Kualifikuar
12. “DRINI-1” shpk & “RAFIN COMPANY” shpk 89,289,839.95 I Skualifikuar
13. “DAJTI PARK 2007” shpk & “Colombo LTD” shpk 89,855,866.70 I Kualifikuar
14. Operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk 89,940,376.93 I Skualifikuar
15. “BIBA-X” shpk & “ALGES KONSTRUKSION” shpk 90,232,353.81 I Skualifikuar
16. Operatori ekonomik “G.P.G. COMPANY” shpk 90,588,411.00 I Kualifikuar
17. Operatori Ekonomik “EUROTEOREMA PEQIN” shpk 93,888,516.09 I Kualifikuar
18. “Caushi M” shpk & “NGRACAN 1934” shpk 94,670,846.00 I Kualifikuar
19. “ERGI” shpk & “BE - IS” shpk 94,912,094.00 I Kualifikuar
20. Operatori ekonomik “CURRI” shpk 95,684,851.11 I Kualifikuar
21. Operatori Ekonomik “BESTA” shpk 96,617,319.00 I Kualifikuar
22. Operatori Ekonomik “LIQENI VII” shpk 97,602,719.35 I Kualifikuar
23. Operatori Ekonomik “SENKA” shpk 99,202,918.39 I Kualifikuar
24. Operatori Ekonomik “UDHA” shpk 102,424,152.24 I Skualifikuar
25. Operatori Ekonomik “BAJRAMI N.” Shpk 104,484,513.25 I Skualifikuar
26. Operatori Ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk 109,544,672.99 I Skualifikuar
27. Operatori Ekonomik “BAMI HOLDING” shpk 118,936,756.47 I Kualifikuar
28. Operatori Ekonomik “DESARET COMPANY” shpk 123,458,868.43 I Kualifikuar

II.4. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton, se operatori ekonomik ankimues “ALBAVIA” SHPK, është skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt-ankimi, sipas arsytimit të dhënë nga autoriteti kontraktor: *“-Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4, ku percaktohet se: “Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjelles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk*

nuk ka deklaruar përmbushjen e detyrimeve për detyrimet nga shoqërisë “Ujësjetles Kanalizime Tiranë” sha.”.

II.5. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton, se me 21.05.2026, është publikuar “Njoftim Fituesi Paraprak” i procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 33, datë 25.05.2026, ku është shpallur fitues OE “INERTI” SH.P.K.

II.6. Në datën 28.05.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1660/2026 protokolli, me datë 28.05.2026, e operatorit ekonomik ankimues “ALBAVIA” Shpk, për procedurën e prokurimit sipër cituar, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1660/1 prot., datë 28.05.2026, lidhur me arsyet e kualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ALBAVIA” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Me shkresën me nr. 21113 prot., datë 05.06.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar më shërbim postar shkresën me objekt “Kërkesë për informacion”, drejtur Komisionit, të protokolluar me tonën me nr. 1660/2 prot., datë 08.06.2026.

II.9. Me shkresën përcjellëse me nr. 22043 datë 11.06.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1660/3 prot., datë 15.06.2026, është dërguar me shërbim postar, nga autoriteti kontraktor, vendimi K.SH.A. mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur **pranimin e pjesshëm** të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.12. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALBAVIA” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij, me pretendimin se: *“.....Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4, ku percaktohet se: “Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjesles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e te gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë”. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk ka deklaruar përmbushjen e detyrimeve për detyrimet nga shoqërisë “Ujësjesles Kanalizime Tiranë” sha.....* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “ALBAVIA” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,* në të cilin parashikohet se *“1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”,* nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ALBAVIA” SHPK, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se mënyra e plotësimit të kriterit 2.2.4 të DT, shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht Komisioni vëren se:

III.1.3. Në pikën 2.2.4 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

4.Vertetim i leshuar nga shoqeria “Ujesjelles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesen e te gjitha detyrimeve qe rrjedhin nga kontratat e furnizimit me uje. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit).

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.1.4. Procesverbali i për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim:

4. Vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “Ujësjelles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenin 39, pika 8 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Bashkia Tiranë nëpërmjet “Ujësjelles Kanalizime Tiranë” sha ka si objektiv kryesor garantimin e shërbimeve jetike të furnizimit me ujë në territorin e Bashkisë Tiranë ku dhe një nga prioritet bazë është mbledhja e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë.. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është për të siguruar Autoritetin Kontraktor që për dhënien e kontratës të kontraktohen operatorë ekonomik të cilët nuk kanë detyrime të pashlyera për furnizimit me ujë sipas objektin ku ushtrojnë aktivitetin, në Bashkinë e Tiranës. Vendsoja e këtij kriteri siguron institucionin e Bashkisë Tiranë edhe në rast detyrimesh të pashlyera, operatorët ekonomik kanë periudhën e nevojshme kohore për të shlyer këto detyrime përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Vendosja e këtij kriteri është propocion me objektin e kontratës, për sa kohë është detyrim i cdo shoqërie shlyerja e detyrimeve të shërbimeve të furnizimit me ujë në territorin ku ushtron aktivitetin, konkretisht Bashkia Tiranë.

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.6. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar

artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.7. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.8. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”*

III.1.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.10. Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 4. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.1.11. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje

me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.12. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij, nga procedura e prokurimit, me arsyetimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se, *Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4, ku percaktohet se: “Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjetles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e te gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë”*. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk ka deklaruar përmbushjen e detyrimeve për detyrimet nga shoqërisë “Ujësjetles Kanalizime Tiranë” sha, KPP vëren se, në përmbushjen e këtij kriteri të DT, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë, që kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit.

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri në fjalë i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “Ujësjetles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë, kriter që sipas autoritetit kontraktor do të konsiderohet i përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo.

Referuar parashikimeve të nenit 82 të *lex specialis* si dhe nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, janë përcaktuar kriteret e kualifikimit të cilat plotësohen me formularin përmbledhës të vetdeklarimit të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga verifikimet rezulton, se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me paraqitjen në formularin përmbledhës të vetdeklarimit të vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “Ujësjetles

Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë, nuk është në përputhje me nenin 82 të LPP dhe nenin 26, pika 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **pasi nuk përfshihet në asnjërën prej rubrikave të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit**. Në bazën ligjore të sipërcituar përcaktohet qartë se cilat janë kriteret e kualifikimit, të cilat plotësohen me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dhe si rrjedhim kriteri i hartuar në këtë mënyrë sjell konfuzion si në përgatitjen e ofertave nga operatorët ekonomik ashtu edhe te organet e vlerësimit të ofertave dhe shqyrtimit të ankesave.

Në përfundim të shqyrtimit të fakteve të sipërcituara, marrë shkas nga verifikimi i strukturës së preventivit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se ky kriter pika 2.2.4 e DT është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, e për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion me shkresën me nr. 22043 datë 11.06.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1660/3 prot., datë 15.06.2026, është dërguar me shërbim postar, nga autoriteti kontraktor, vendimi K.SH.A. mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur **pranimin e pjesshëm** të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku ka pranuar se për këtë pikë operatori ekonomik ankimiues ka të drjetë dhe kjo përmbën shkak për anulimin e kësaj proceure prokurimi. Në këto kushte, Komisioni vlerëson të drejtë arguementimin dhe arsyetimin e Komisionit të Vlerësimit të Ankesave, dhe lejon autoritetin kontraktor të vijojë me hapat procedural të mëtejshëm për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në vijim, në rast të rishpalljes së saj, autoriteti kontraktor duhet të risjellë DST e reja para publikimit të tyre me kriterin 2.2.4 të modifikuar dhe të mbajë në konsideratë, parashikimet e 82 të LPP dhe nenit 26, pika 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, të qarta, jo konfuze , si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ashtu si edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. KPP i sjell në vëmendje autoritetit kontraktor që në hartimin e kriterëve për kualifikim duhet t’i qëndrojë strikt parashikimeve të legjislacionit për prokurimin publik në fuqi duke evidentuar plotësimin përmes formularit përmbledhës të vetëdeklarimit vetëm të atyre kriterëve të cilat në kuptim të nenit 82 të lex specialis dhe të nenit 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 në këtë fazë plotësohen përmes tij. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë autoriteti kontraktor ka hartuar një kriter në kundërshtim me

dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik dhe duhet të marrë masa për të vijaur me anulimin e procedurës së prokurimit.

III.1.13. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...],

KPP gjykon se, hartimi i kriterin 2.2.4 i DT në procedurën e prokurimit objekt ankimi, mbi bazën e të cilit është bërë edhe përzgjedhja e fituesit, nuk është në përputhje me nenin 82 të LPP dhe nenin 26, pika 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi, duke krijuar konfuzion mbi plotësimin e tij dhe i vendos në kushte pabarazie ofertuesit e interesuar.

Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ALBAVIA Sh.p.k” në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur”, me Nr. REF-76125-02-13-2026, me objekt “Rikualifikimi i bllokut të banimit në rrugët Nexhat Agolli, Nikolla Dushniku, Ndoc Nikaj”, me fond limit 141,720,264.94 (njëqind e dyzet e një milion e shtatëqind e njëzet mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe të dërgojë hard-copy e DTS së re, përpara publikimit.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit të rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “ALBAVIA Sh.p.k”, konkretisht nuk jam dakord me arsyetimin në pikën III.1 e në vijim, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALBAVIA Sh.p.k” në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-76125-02-13-2026, me objekt “Rikualifikimi i bllokut të banimit në rrugët Nexhat Agolli, Nikolla Dushniku, Ndoc Nikaj”, me fond limit 141,720,264.94 (njëqind e dyzet e një milion e shtatëqind e njëzet mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALBAVIA” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij, me pretendimin se: “.....*Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4, ku përcaktohet se: “Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjesles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk ka deklaruar përmbushjen e detyrimeve për detyrimet nga shoqërisë “Ujësjesles Kanalizime Tiranë” sha. anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik, z. Kreshnik Ternova (Anëtar), vëren se*”

III.1.2. Në pikën 2.2.4 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

4.Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjesles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit). Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti

Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

III.1.3. Procesverbali i për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim:

4. Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjetles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenin 39, pika 8 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Bashkia Tiranë nëpërmjet “Ujësjetles Kanalizime Tiranë” sha ka si objektiv kryesor garantimin e shërbimeve jetike të furnizimit me ujë në territorin e Bashkisë Tiranë ku dhe një nga prioritet bazë është mbledhja e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë.. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është për të siguruar Autoritetin Kontraktor që për dhënien e kontratës të kontraktohen operatorë ekonomik të cilët nuk kanë detyrime të pashlyera për furnizimit me ujë sipas objektin ku ushtrojnë aktivitetin, në Bashkinë e Tiranës. Vendsoja e këtij kriteri siguron institucionin e Bashkisë Tiranë edhe në rast detyrimesh të pashlyera, operatorët ekonomik kanë periudhën e nevojshme kohore për të shlyer këto detyrime përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Vendosja e këtij kriteri është propocion me objektin e kontratës, për sa kohë është detyrim i cdo shoqërie shlyerja e detyrimeve të shërbimeve të furnizimit me ujë në territorin ku ushtron aktivitetin, konkretisht Bashkia Tiranë.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.5. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”*

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe

“j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.9. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.10. Arsyetohet se Anulimi i procedurë për të kundërshtuar kriteret në fazën e vlerësimit/skualifikimit do të cenonte **sigurinë juridike**, do të krijonte **pasiguri procedurale** dhe do ta detyronte autoritetin kontraktor të rihapte paligjshmërisht diskutimin mbi kriteret që nuk janë ankimuar në kohë.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i Ekstraktit të thejshëm në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), u konstatua se operatori ekonomik ankimues është subjekt me ushtrim të aktivitetit në qytetin e Tiranës me adresë “Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19, Tiranë”, çka e bën operatorin ekonomik ankimues lidhet drejtpërdrejt me kërkesën për përmbushjen e detyrimeve ndaj Ujësjetës Kanalizime Tiranë.

Në ligjin e Prokurimit Publik është perkluzive që operatori ka detyrimin të përgatisë ofertën sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, për sa kohë i ka pranuar ato dhe nuk i ka bërë objekt ankimi.

Vlerësoj se pretendimi i operatorit ekonomik mbi ligjshmërinë, proporcionalitetin, qartësinë apo mënyrën e formulimit të kriterit është ngritur jashtë momentit procedural të parashikuar nga ligji. Sipas praktikës së konsoliduar të KPP-së, operatori ekonomik që ka pretendime mbi kriteret, specifikimet teknike apo kërkesat e dokumenteve të tenderit duhet t'i godasë ato nëpërmjet ankimit ndaj dokumenteve të tenderit, brenda afatit të parashikuar në nenin 110/1 të ligjit nr. 162/2020. Mosushtimi i kësaj të drejte brenda afatit ligjor sjell prekludimin e pretendimit dhe nuk lejon rihapjen e debatit mbi kriterin në fazën e vlerësimit, kualifikimit apo skualifikimit të ofertës. Në rast paqartësie, operatori ekonomik kishte gjithashtu mjetin procedural të kërkesës për sqarime sipas nenit 75 të ligjit. Për sa kohë kriteri është publikuar, është pranuar dhe nuk është bërë objekt ankimi në kohë, operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë ofertën në përputhje me këtë kriter.

Akoma më tej, Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik sjell në vëmendje, se në rast se operatori ekonomik ankimues “ALBAVIA” SHPK do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110, pika 1 e LPP. Në nenin 110 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së.

Në nenin 75, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

“[...]1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i

kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.. [...]”

Anëtari i KPP-së, gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë ofertues të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

1. Vendim KPP nr. 572/2025, datë 29.04.2025

KPP shprehet se operatorët ekonomikë, përfshirë ankimuesin, **kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit**, sipas nenit 110/1 të ligjit nr. 162/2020. Më tej, KPP e cilëson afatin **prekluziv**, mosrespektimi i tij sjell humbjen e së drejtës për të ngritur më vonë pretendime mbi përmbajtjen e dokumenteve të tenderit.

Arsyetoj se Anulimi i procedurë për të kundërshtuar kriteret në fazën e vlerësimit/skualifikimit do të cenonte **sigurinë juridike**, do të krijonte **pasiguri procedurale** dhe do ta detyronte autoritetin kontraktor të rihapte paligjshmërisht diskutimin mbi kritere që nuk janë ankimuar në kohë.

2. Vendim KPP nr. 816/2025, datë 27.06.2025

KPP thotë se nëse operatori ekonomik kishte pretendime për **kriteret apo specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit**, ai kishte momentin procedural për t'i goditur ato me ankesë sipas nenit 110/1 të ligjit nr. 162/2020. Akoma më tej nëse operatori kishte paqartësi mbi përmbushjen e kriterit, kishte mundësi të kërkonte **sqarime sipas nenit 75** përpara dorëzimit të ofertës.

Ligjvënësi e lidh mosankimimin e kriterit me detyrimin e operatorit që të përgatisë ofertën sipas kritereve të publikuara, për sa kohë ato janë pranuar dhe nuk janë bërë objekt ankimi.

3. Vendim KPP nr. 520/2026, datë 21.04.2026

KPP shprehet qartë se nëse operatori ekonomik kishte pretendime mbi kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, ai kishte momentin procedural për të paraqitur ankesë mbi hartimin e dokumenteve të tenderit sipas nenit 110/1. KPP përsërit ndarjen 10 ditë / 7 ditë, sipas vlerës së procedurës.

KPP thekson se në rast paqartësie operatori kishte mjetin procedural të kërkesës për sqarime sipas nenit 75, dhe se oferta duhet të përgatitet sipas kritereve të pranuar dhe të paankimuara.

4. Vendim KPP nr. 212/2026, datë 09.02.2026

KPP shprehet se nëse operatori kishte paqartësi mbi përmbushjen e kërkesës, ai kishte momentin procedural për të kërkuar sqarime sipas nenit 75, dhe se operatorët duhet të përgatisin ofertat sipas kriterëve të dokumenteve të tenderit kur ato janë pranuar dhe nuk janë ankimuar.

5. Vendim KPP nr. 365/2026, datë 09.03.2026

KPP përdor të njëjtën logjikë: nëse operatori kishte paqartësi mbi kriterin/kërkesën, duhej të kërkonte sqarime në kohë; përndryshe oferta vlerësohet mbi kriteret e publikuara dhe të paankimuara.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankmiues “Albavia shpk” nuk qëndron.

Si rrjedhojë e arsyetimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 34, 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjykoj:

1. Të mos pranohet ankesa e operatorit ekonomik “ALBAVIA” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-76125-02-13-2026, me objekt “Rikualifikimi i bllokut të banimit në rrugët Nexhat Agolli, Nikolla Dushniku, Ndoc Nikaj”, me fond limit 141,720,264.94 (njëqind e dyzet e një milion e shtatëqind e njëzet mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Anëtar
Kreshnik Ternova

